

Qendra Kombëtare e Biznesit, në mënyrën e funksionimit të saj lidhur me organizimin e funksionimit të shërbimit arkivor si dhe detyrave ligjore për krijimin, ruajtjen dhe shfytëzimin e pasurisë arkivore si pjesë e trashëgimisë kombëtare, bazohet në Ligjin Nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.

Në fillim të vitit 2025 janë proceduar nga institucioni si më poshtë vijon:

Në bazë dhe zbatim të pikës 3, të nenit 5, të Ligjit Nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat” dhe në zbatim të vendimit përfundimtar nr.7270/5, datë 14.07.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave është urdhëruar për vijimin e procedurave të përpunimit të dokumenteve me RHK dhe me përpunimin e dokumenteve me afat të përkohshëm; për kryerjen e inventarizimit dhe dorëzimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, të dokumenteve të përpunuara për vitin 2011-2012 brenda vitin 2025 (shtator 2025) si dhe dorëzimi për vitet 2013-2014 brenda vitit 2026, nga nëpunës civil të strukturës përgjegjëse; gjithashtu të vijoje procesi i përpunimit tekniko-shkencor të dokumentave arkivore deri në inventarizimin e plotë të tyre.

Në bazë dhe zbatim të pikës 3, të nenit 5, të Ligjit Nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të nenit 7 të Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për Arkivat” dhe Nenit 5 të Vendimit Nr. 4, datë 19.06.2017, “Për miratimin e “Rregullores së Njëhësuar të Punës me Dokumentat në Autoritetet Publike në Republikën e Shqipërisë”, është ngritur Komisioni i Ekspertizës për Qendrën Kombëtare të Biznesit, i cili mblidhet të paktën një herë në vit dhe i cili harton listën e dokumentave me rëndësi historike kombëtare dhe të dokumentave me afat ruajtje të përkohshme si dhe përcakton afatet e ruajtjes së këtyre të fundit sipas Listës Tip të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 7, të Vendimit Nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e “Rregullores së njëhësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, bazuar dhe në procesverbalin e Komisionit të Ekspertizës, është miratuar nga titullari i institucionit pasqyra emërtuese për çeljen e dosjeve për vitin 2025.